



MARTESA

MUHAMED IBËN SALIH ELÜTHEJMIN

الزواج

Martesa

Autori:
Muhamed ibën Salih elUthejmin

Përktheu:
Besim Gjellaj

Redaktor gjuhësor:
Sylë Dinaj

Titulli në arabisht: الزواج

Titulli në shqip: Martesa

Autor: Muhamed ibën Salih elUthejmin

Përkthyes: Besim Gjellaj

Redaktor gjuhësor: Sylë Dinaj

Website: www.indeksiislam.com

All rights reserved

ان الحمد لله، نحمده ونستعينه ونستغفره، ونعوذ بالله من شرور أنفسنا ومن سيئات أعمالنا، مَنْ يَهْدِهِ اللهُ فَلَا مُضِلَّ لَهُ، وَمَنْ يَضِلَّ فَلَا هَادِيَ لَهُ، وَأَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ،

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ﴾¹

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا﴾²

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا﴾³

أما بعد

فإنَّ أصدق الحديث كلام الله تعالى، وخير الهدي هدي محمدٍ صلى الله عليه وسلم وشر الأمور محدثاتها، وكلُّ محدثةٍ بدعةٌ، وكلُّ بدعةٍ ضلالةٌ، وكلُّ ضلالةٍ في النار

¹ [آل عمران: 102]

² [النساء: 1]

³ [الأحزاب: 70 - 71]

Hyrje

Falënderimet i takojnë All-llahut, Atë e falenderojmë, dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë dhe tek Ai pendo kemi.

Kërkojmë mbrojtjen e All-llahut nga të këqijat e vetës sonë dhe nga të këqijat e veprave tona, atë që All-llahu e udhëzon s'ka kush që e humbë, e atë që e humbë s'ka kush që e udhëzon.

Thotë All-llahu I lartësuar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ

“O ju që besuat, kinie frikë All-llahun me një sineritet të vërtetë dhe mos vdisni, pos vetëm duke qenë muslimanë (besimtarë)⁴.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رَجُلًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا

“O ju njerëz! Kinie frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kinie frikë All-llahun që më ëmrin e Tij përбетoheni, ruajeni farefisnin (akrallëkun), se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju”⁵ .

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا

“O ju besimtarë, përmbajuni mësimave të All-llahut dhe thuani fjalë të drejta. Ai (All-llahu iu mundëson të bëni vepra të mira, ju shlyen juve mëkatet tuaja, e kush e respekton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, ai ka arritur një sukses të madh”⁶.

⁴ (Ali imran 102)

⁵ (En- Nisa 1)

⁶ (El-Ahzab 70-71)

Kapitulli i parë

Martesa (Nikahu)

Nikah gjuhësisht d.m.th. akti i kurorizimit apo të kryerit e marrdhenieve më gruan.

Ka thënë Ebu Alij-j el-Kalij-j: "Arabët kanë bërë një dallim të thjeshtë në mes të aktit të kurorizimit dhe të kryerit të marrdhenieve më gruan; nëse thonë: e ka kurorizuar filanen apo të bijën e filanit, kanë për qëllim aktin e kurorizimit, e nëse thonë: e ka kurorizuar gruan e tij apo bashkëshortën e tij, nuk kanë për qëllim diqka tjetër pos marrdhenieve intime".

Kurse në terminologjinë islame nikah d.m.th. kurorizimi në mes burrit dhe gruas më qëllim për të gjetur kënaqësi çdo njëri prej tjetrit, si dhe formimi i një familjeje të mirë dhe shoqërie të shëndoshë.

Nga këtu nxjerrim në pah se me aktin e kurorizimit nuk synohet vetëm kënaqësia seksuale, përkundrazi synohet një kuptim tjetër e ai është: "Formimi i familjeve të mira dhe i shoqërive të shëndosha". Mirëpo, ndodhë ndonjëherë që njëri prej synimeve të jetë më i theksuar se tjetri, e kjo varësisht nga gjendja e njerzve (personave).

Kapitulli i dytë

Vendimi i Islamit për martesën

Nikahi në vetvetën e tij është legjitim, i preferuar për çdonjeri që posedon epsh dhe ka mundësi materiale për të.

Është prej traditës se Pejgamberve alejhimus-selam, All-llahu i lartësuar thotë:

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلًا مِّن قَبْلِكَ وَجَعَلْنَا لَهُمُ أَزْوَاجًا وَذُرِّيَّةً

"Ne dërguam edhe para teje të dërguar dhe atyre u mundësuam të kenë gra e fëmijë..."⁷.

Gjithashtu edhe Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem është martuar dhe ka thënë: **"Unë martohem, ai i cili nuk është i kënaqur me sunnetin tim, nuk është prej meje"**⁸.

Për këtë edhe dijetarët kanë thënë: "Të jesh i martuar në kohën kur ke epsh është me e vlefshme se ibadeti vullnetar (nafilet)", për arsye se pas kësaj martese pasojnë dobi të mëdha dhe rezultate të këndshme, të cilat disa prej tyre do t'i sqarojmë me poshtë in she All-llah.

Nganjëhere nikahu është i obliguar (vaxhib) si p.sh.: nëse mashkulli ka epshin e fortë dhe ka frikë se do bie në haram nëse nuk martohet, në këtë rast martesa për ta ruajtur vetvetën dhe për t'a ndalur nga harami është vaxhib.

⁷ (Err-Rrad 38)

⁸ Tra. Buhariu (5063), Muslimi (1401).

I Dërguari sal-lall-Ilahu alejhi ue sel-lem thotë: "**O ju të rinjë! Kush ka mundësi të martohet, le të martohet sepse ajo e ruan shikimin e tij dhe e mbron organin (nderin) e tij, e kush nuk ka mundësi le të agjerojë, sepse kjo është mburojë për të**"⁹ .

⁹ Tra. Buhariu (5066, Muslimi (1400).

Kapitulli i tretë

Kushtet e martesës

Prej mirësisë se legjislacionit islam dhe saktësisë së tij në vurjen e dispozitave është që për çdo akt çfardo qoftë ai ka vendosë rregulla me të cilat rregullohen ato, dhe përcaktohet vlefshmëria e tyre për t'u zbatuar dhe për të funksionuar, kështu që çdo akt ka kushte pa të cilat nuk realizohet, e ky është agument i qartë në vërtetësinë e sheriatit dhe përkryshmërinë e tij, dhe se ai (sheriati) ka ardhur prej të Urtit dhe të Gjithëdijshmit, i Cili e din çfarë është e dobishme për krijesat, i Cili iu lejon atë që ju bën dobi në fenë e tyre dhe në këtë botë, kështu që mos të çrregullohet gjendja dhe të jetë një kaos i vërtetë.

Në mesin e këtyre akteve është edhe akti i nikahut, i cili ka disa kushte që do t'i përmendim më poshtë, e më e rëndësishmja është:

1. **Pëlqimi i ndërsjellë mes dy bashkëshortëve;** nuk lejohet të detyrohet burri që t'a martojë atë që nuk e do, gjithashtu nuk lejohet të detyrohet femra që ta martojë atë që nuk e do.

All-llahu i lartësuar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا يَحِلُّ لَكُمْ أَنْ تَرِثُوا النِّسَاءَ كَرِهًا
**"O ju që besuat, nuk është e lejuar për ju të
trashëgoni gratë (e të vdekurve) në mënyrë të
dhunshme..."**¹⁰.

¹⁰ (En-Nisa 19)

Gjithashtu edhe i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem thotë: ***"Nuk lejohet martesë e të vejës përderisa të mos e pytenë, e as e vajzës së virgjër përderisa mos të kërkohet leje prej saj; sahabet i thanë: O i Dërguar i All-llahut e si është leja e saj (të virgjërës)? Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem tha: që të heshtë"***¹¹,

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem e ka ndaluar për ta martuar femrën pa pelqimin e saj, varësisht se a është virgjreshë apo e vejë, përveqse e veja patjeter duhet të pohojë më fjalë kurse të vajza e virgjër mjafton heshtja e saj sepse ndoshta turpërohet të pohojë më fjalë për pelqim martësor.

Nëse nuk pranon të martohet, nuk është e lejuar për askënd ta detyrojë të martohet qoftë edhe prindi, bazuar në fjalën e Pejgamberit sal-all-llahu alejhi ue sel-lem: ***"Vajzen e virgjër e pytë prindi (babai)"***¹².

Ndaj prindit në këtë rast nuk ka mëkat nëse nuk e marton, ngase ajo vet nuk ka dashur të martohet, mirëpo prindi e ka obligim ta ruajë dhe të kujdesët për të.

Nëse dy persona e kërkojnë (dorën e saj), dhe thotë e dua këtë person kurse veliu (shiko kushtin Nr. 2) thotë fejohu për tjetrin, në këtë rast femra duhet të martohet më atë që e deshiron ajo nëse është i përshtatshëm për të, e nëse nuk është i përshtatshëm për të, veliu ka të drejtë të ndërhyjë dhe ta pengoi nga martesë më të dhe në këtë rast nuk ka farë mëkat.

¹¹ Tra. Buhariu (5136), Muslimi (1419).

¹² Tra. Muslimi (1421).

2. **Veliu**; kurorizimi nuk është i vlefshëm pa veliun, bazuar në fjalën e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ku thotë: **“Nuk ka nikah përveç me veli”**¹³ nëse femra e marton vetën pa dijën e veliut, nikahu i saj konsiderohet i pavlefshëm, pavarësisht a e ka bërë nikahun vetë apo e ka autorizuar dikë.

Veliu është a i cili ka arritur moshën e pjekurisë, është i shëndosh mentalisht, i mençur (e di realitetin e martesës) dhe duhet të jetë i afërm i saj, si p.sh.:babai, gjyshi nga ana e babait, djali, nipi e kështu me radhë, vllau, vllau prej babe, axha, vllau i babait prej babes, si dhe fëmijet e tyre të afërm e më të afërm, kështu veliu nuk mund të jenë vëllëzrit nga nëna, fëmijët e tyre, as gjyshi nga ana e nënës as dajallarët.

Për derisa nikahu nuk bëhet pa veliun, atëherë për veliun është obligim të zgjedhë atë që është më i miri nëse kërkesat për ta fejuar janë të shumta, e nëse e kërkon vetëm një dhe është i përshtatshëm edhe femra gjithashtu e pëlqen e ka obligim ta martojë për të.

Këtu do ndalemi pak kështu që ta kemi të njohur se çfarë përgjegjesie ka veliu ndaj atijë që All-llahu i Lartësuar e ka bërë përgjëgjës, ngase kjo punë me të vërtetë është emanet prej All-llahut, e ka obligim të kujdeset për të dhe ketë amanet duhet ta vendosë në vendin e vetë, nuk i lejohet të manipulojë më të për qëllime personale ose ta martojë më dikë që nuk përshtatet për shkak se ai lakmon në diç që i afrohet për të, ngase kjo konsiderohet tradhti, thotë All-llahut az-ze ve xhel:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَخُونُوا اللَّهَ وَالرَّسُولَ وَتَخُونُوا أَمَانَاتِكُمْ وَأَنْتُمْ تَعْلَمُونَ

“O ju që besuat, mos e tradhtoni All-llahun dhe të dërguarin, e ashtu të tradhtoni amanetet tuaja, derisa e dinë sa e keqe është kjo”¹⁴.

¹³ Tra. Ebu Davudi (2085), Tirmidhiu (1101), Iben Maxheh (1881).

¹⁴ (El-Enfalë 27).

Gjithashtu All-llahu i lartësuar në një ajet tjetër thotë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ كُلَّ خَوَّانٍ كَفُورٍ

***"All-llahu nuk e do asnjë tradhtarë e bukëpërmbystë"*¹⁵.**

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem thotë: ***"Çdo njëri është kujdestar dhe do të jap përgjegjesi për atë që i është dhënë nën kujdesje"***¹⁶.

I vren disa persona ua kërkon vajzën e tyre ndokush që është i përshtatshëm për ta fejuar, pastaj e refuzon atë, e e refuzon tjetrin, e tjetrin, e kush është i tillë pozita e tij si veli bie, dhe kështu të drejtën e martesës se saj e merr dikush tjetër nga me të afërmit e saj.

3. Deshmitarët, thotë Ibën Abbasi Allahu qoftë i kënaqur me të: ***"Nuk ka nikah përveç me dy deshmitarë dhe veli të drejtë"***¹⁷.

4. Meh'ri, thotë All-llahu: وَءَاتُوا النِّسَاءَ صَدُقَاتِهِنَّ نِحْلَةً
"Grave jepnu dhuratën e kurorës se tyre (niqahin) më të mire..."¹⁸.

¹⁵ (El- Haxh-xh 38)

¹⁶ Tra. Buhariu (5188), Muslimi (1829).

¹⁷ (Ibën Rushdi, el-Bidaj-jeh, 3/964)

¹⁸ (En-Nisa 4), (el-Bidajeh, 3/966)

Kapitulli i katërt

Cilësit e femres më të cilën duhet martuar

Më nikah është për qëllim arritja e kënaqësis mes dy bashkëshortëve, formimi i familjës se mirë dhe i shoqërisë së shëndoshë, ashtu siç e kemi cekur me fillim.

Sipas kësaj femrën të cilën duhet martuar është ajo e cila i përmban dy cilësi, ajo është e cila cilësohet me bukuri fizike dhe bukuri shpirtërore:

- bukuria trupore është; të jetë pa pasoja fizike, sepse femra sa më e bukur të jetë, sa më gojëëmbel, të pushojnë sytë në të shiquarit e saj, të përqëndrohen veshët në fjalët e saj, të hapet zemra për të, të zgjerohet gjoksi, si dhe shpirti të gjenë prehje në të, vetëm se e vërteton fjalën e All-llahut të Lartësuar:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ
بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً إِنَّ

“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë.”¹⁹

- bukuria shpirtërore (devotshmëria) është; të jetë e kapur për feje plotësisht, të ketë moral, sepse sa më e devotshme dhe sa më moralshme të jetë gruaja do të jetë më e dashur për bashkëshortin dhe do të kanë një përfundim të suksesshëm.

¹⁹ (Err-Rrum 21)

Femra e devotshme, është e përkushtuar ndaj urdhërave të All-llahut, është e kujdesshme ndaj bashkëshortit të saj, nderit, fëmijëve dhe pasurisë së tij, është përkrahse e bashkëshortit të saj për t'iu përlur All-llahut të Lartësuar, nëse harron diçka ia përkujton, nëse lodhet e relakson, e nëse hidhërohet e bën të kënaqët.

Femra e edukuar është e dashur te burri i saj dhe ajo e rrespekton atë, nuk vonohet në ndonjë gjë të cilën burri e dëshiron të shpejtohet, apo nuk nxiton në atë që bashkëshorti dëshiron të vonohet.

Është pyetur i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ue se-lem: ***"Cilat gra janë më të mirat? Tha: "Ajo që e bënë burrin të lumtur nëse e shikon, i përulet kur e urdhëron, nuk e kundërshton (qoftë të kundërshtuarë në urdhëra të tij apo në diç tjetër), si dhe nuk e shpenzon pasurin aty ku nuk ka dëshirë"***²⁰.

Po ashtu ka thënë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem: ***"Martoni ato gra që janë të dashura (tërheqëse) e që linden shumë, sepse unë krenohem para pejgamberëve tjerë më shtimin e shumtë të juaj" ose ka thënë: "para umeteve"***²¹.

Nëse ka mundësi të gjejë femër e cila ka bukurin e jashtme (fizike) dhe të brëndshme (shpirtrore), më të vërtetë kjo është përkryeshmëri dhe lumturi më ndihmën e All-llahut të Lartësuar.

²⁰ Tra. Ahmedi (2/251), Nesaiu (3231).

²¹ Tra. Ebu Davudi (2050), Nesaiu (3227).

Kapitulli i pestë

Martestat e ndaluara

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë: ***“All-llahu ka bërë obligime dhe mos i leni ato, ka caktuar kufij, pra mos i tejkaloni”***²².

Prej këtyre përcaktimeve ligjore të cilat All-llahu i ka kufizuar kufijët e tyre është martesa, ku e ka bërë të ndaluar martesën për burrin me gra të caktuara qoftë ajo për shkak të farefisnisë apo gjidhënies apo dhëndërisë apo për ndonjë shkak tjetër.

Martesa e ndaluar më gra ndahet në dy lloje:

- e ndaluar përgjithmonë;
- e ndaluar përkohësisht.

Martesa e ndaluar përgjithmonë është tri lloje:

A. martesa e ndaluar për shkak të farefisnisë, e ato janë shtatë kategori të cilat i ka përmend All-llahu i lartësuar në fjalën e Tij:

حُرِّمَتْ عَلَيْكُمْ أُمَّهَاتُكُمْ وَبَنَاتُكُمْ وَأَخَوَاتُكُمْ وَعَمَّاتُكُمْ وَخَالَاتُكُمْ وَبَنَاتُ الْأَخِ وَبَنَاتُ الْأُخْتِ

“U janë ndaluar juve (të martoheni me): nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, hallat tuaja, tezeta tuaja, bijat e vëllaut, bijat e motrës...”²³.

²² Tra. Darekutni ne sunenin e tij (4/184).

²³ (En-Nisa 23)

1. nënat, e këtu hynë edhe gjyshet qoftë nga ana e babait apo nënës.
2. bijat, e këtu hynë edhe bijat e djemve dhe bijat e bijave.
3. motrat (nga babai dhe nëna), e këtu hynë edhe motrat nga babai si dhe motrat nga nëna.
4. hallat, e këtu hynë edhe hallat e babait, hallat e gjysheve, hallat e nënës si dhe hallat e gjysheve.
5. tezet, e këtu hynë edhe tezet e babait, të gjyshërve, tezët e nënës si dhe tezet e gjysheve.
6. vajzat e vllaut (nga babai dhe nëna), e këtu hynë edhe vajzat e vllaut nga babai, vajzat e vllaut prej nënë, vajzat e djemve të vëllaut si dhe vajzat e vajzave të tyre.
7. vajzat e motrës (nga babai dhe nëna), e këtu hynë edhe vajzat e motrës nga babai, vajzat e motrës prej nënë, vajzat e djemve të motres si dhe vajzat e vajzave të tyre.

B. martesë e ndaluar nga qumshti, e ato janë po të njëjtat që ndalohen nga farefisi, Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "**Ndalohet nga qumshti çdo gjë që ndalohet nga farefisi**"²⁴. Mirëpo ndalesa nga qumshti patjetër duhet t'i plotësojë disa kushte, e ato janë siç vijon:

1. të ketë pirë qumësht pesë herë e më shumë, nëse foshnja ka pirë katër herë, nuk konsiderohet nënë e tij nga qumështi, bazuar në hadithin e transmetuar në Muslimi nga Aisheja Allahu qoftë i kënaqur me të, e cila thotë: "**Në fillim të zbritjes së Kur'an-it ka qënë e njohur dhjetë thithje të gjiut e kanë bërë haram martesën, pastaj është degraduar në pesë, e është vdekur i Derguari sal-lallahu alejhi ue sel-lem dhe kjo ka mbetur ashtu si lexohet në Kur'an**"²⁵.

²⁴ Tra. Buhariu (2645, 2646), Muslimi (1444, 1447).

²⁵ Tra. Muslimi (1452).

2. të jetë pirja e qumshtit para ndarjës së foshnjës nga gjiri, d.m.th. është kusht që pesë thithjet e gjirit të jenë para kësaj kohe, nëse pinë pas ndarjes ose disa thithje i bënë para ndarjës e disa pas, gjidhënseja në këtë rast nuk konsiderohet nënë nga qumështi.

Në qoftë se plotësohen kushtet e gjidhënies, foshnja konsiderohet fëmijë i gjidhënses, fëmijet e saj konsiderohen vëllëzër të tij, varësisht se a janë lindur para apo pas tij, gjithashtu fëmijet e burrit të gjidhënses janë vëllëzër të tij, varësisht se a janë prej gruas të cilës ka thithur gji apo prej ndonjë gruaje tjetër.

Këtu duhet të dimë se të afërmit e fëmiut që ka pirë gji nga një grua nuk kanë lidhje me këtë thithje të gjirit dhe nuk ndikon fare tek ta më përjashtim të pasardhësve të tij, dhe është e lejuar për vllaun e tij të martohet me nënën e vëllaut të vet nga qumështi si dhe më motrën e vllaut të vet nga qumështi.

Kurse pasardhësit e fëmiut (që ka pirë gji), konsiderohen fëmijë të gjidhënses, ashtu siç konsiderohet babai i tyre.

C. martesë e ndaluar nga ana e dhëndërisë, janë:

1. gratë e prindërve dhe të gjyshërve qoftë nga ana e babait apo nënës, bazuar në fjalën e All-llahut të Lartësuar;

وَلَا تَنْكِحُوا مَا نَكَحَ آبَاؤُكُمْ مِنَ النِّسَاءِ

"Mos u martoni me ato gra me të cilat kanë qenë të martuara prindërit tuaj..."²⁶.

²⁶ (En-Nisa 22)

Në momentin kur njëriu e bënë aktin e kurorizimit me ndonjë grua, gruaja e tij konsiderohet haram për bijët e tij, bijët e djemve, për djemët e djemve të tyre, si dhe për bijët e bijave të tyre, e kështu me radhë, pa marrë parasysh a ka pasur marrdhënie intime me të apo jo.

2. gratë e djemve e kështu më radhë, All-llahu i lartësuar thotë:

عَلَيْكُمْ وَحَلَالُ أَبْنَائِكُمُ الَّذِينَ مِنْ أَصْلَابِكُمْ

"...dhe (janë të ndalaura) gratë e bijve tuaj që janë të lindjes suaj (jo të bijëve të adoptuar)..."²⁷.

Sapo ta kurorëzojë djali gruan, gruaja e tij konsiderohet haram për babain dhe qyshërit e tij e kështu më radhë qofshin gjyshërit nga ana e babait apo nënës, d.m.th. pas kryerjes se aktit të nikahut edhe nëse nuk ka bërë marrdhënie më të.

3. nëna e gruas, gjyshet e saj e kështu më radhë, bazuar në fjalën e All-llahut të lartësuar:

الرَّضَاعَةَ وَأُمَّهَاتُ نِسَائِكُمْ

"...nënat e grave tuaja (vjehrrat)..."²⁸.

Do të thotë se më kryerjën e aktit të kurorizimit, nëna dhe gjyshet e saj konsiderohen të ndaluara edhe nëse nuk ka pasur marredhënie intime më të, pa marrë parasysh se a janë gjyshet nga ana e babait apo nënës.

²⁷ (En-Nisa 23)

²⁸ (En-Nisa 23)

4. bijat e gruas, vajzat e bijve si dhe vajzat e bijave të saj e kështu më radhë, këtu hyjnë vajzat e gruas dhe pasardhëset e tyre, mirëpo më kusht që të ketë marrdhënie më nënën e tyre, nëse ndodh shkurorizimi para kryerjes së marrdhënieve intime, atëherë vajzat e gruas dhe pasardhëset e tyre nuk janë të ndaluara, sepse All-llahu i lartësuar thotë:

نِسَائِكُمْ وَرَبَائِبُكُمُ اللَّاتِي فِي حُجُورِكُمْ مِّن نِّسَائِكُمُ اللَّاتِي دَخَلْتُم بِهِنَّ فَإِنْ لَّمْ تَكُونُوا دَخَلْتُم بِهِنَّ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ

"...dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja më të cilat patët kontakt (marrdhënie intime), e nëse nuk keni pasur kontakt me to (me gratë), atëherë s'ka pengesë (të martoheni me ato vajza)..."²⁹.

Pra, sapo të martohet burri më ndonjë grua dhe bën marrdhënie më të, vajzat e saj, vajzat e bijve dhe bijave të saj e e kështu më radhë konsiderohen haram për të, pa marrë parasysh a janë nga martesë më burrin e parë apo me të dytin.

Nëse shkurorizimi është bërë para marrdhënieve intime, atëherë vajzat e gruas dhe pasardhëset e tyre nuk janë haram ndaj tij.

²⁹ (En-Nisa 23)

Martesa e ndaluar përkohësisht dhe llojet e saj:

1. motra e gruas, halla dhe tezja e saj, përderisa nuk ndahet nga gruaja dhe derisa ta kryen kohën e idetit të saj, Allahu I lartësuar thotë:

أَصْلَابُكُمْ وَأَنْ تَجْمَعُوا بَيْنَ الْأُخْتَيْنِ إِلَّا مَا قَدْ سَلَفَ

“...dhe të bashkoni (përnjëherë në një nikah) dy motra...”³⁰.

Gjithashtu edhe Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem thotë: **“Nuk lejohet të bashkohet në mes gruas dhe hallës se saj, e as mes gruas dhe tezes se saj”³¹.**

2. ideti³² i burrit të kaluar, nëse gruaja është duke e kryer idetin e burrit te parë që është ndarë prej tij, atëherë nuk lejohet ta kurorëzojë ndokush para kryerjes se idetit.

Gjithashtu nuk lejohet për ta fejuar dikush nëse është në kohën e idetit përderisa të kryhet ideti.

3. në kohën e haxhit apo umres, nuk lejohet të bëhet akti i martesës përderisa është në ih’ram.

Këtu duhet të kemi parasysh se ka edhe gjëra tjera që e bëjnë martesën haram përkohësisht, mirëpo nuk po i cekim nga frika se mos po e zgjasim shumë.

Kurse haidi-menstruacionet nuk janë pengesë për kryerjen e aktit martesorë, pra, lejohet akti i nikahut edhe nëse është në kohën e haidit, mirëpo nuk lejohet kryerja e marrdhënieve, derisa t’i ndërprehët haidi dhe të pastrohet.

³⁰ (En-Nisa 23)

³¹ Tra. Buhariu (5109), Muslimi (1408).

³² Ideti është pengesë e cila e detyron gruan të qëndroj përkohësisht e pa martuar si shkak i zhvleftësismit të nikahit apo diç e ngjajshme më të.

Kapitulli i gjashtë

Poligamia e lejuar

Pasi që martesë më shumë gra ka qënë shkak për të sjellur çrregullime dhe padrejtësi, gjithashtu mosmundësia për t'i përmbushur obligimet ndaj tyre, kurse në anën tjetër kufizimi i njeriut më një grua sjellë të këqija, masandej shuarja e epshit në forma tjera është e ndaluar, si rrjedhojë e tërë kësaj sheriatit islam e ka bërë të lejuar martesën me katër gra, ngase ky është numër që njeriu ka mundësi ta realizojë drejtësinë në mes tyre, ta përmbushë obligimin si bashkëshort ashtu si duhet, si dhe e plotëson nevojën e vetë nëse ka nevojë për më shumë se një grua.

All-llahu i lartësuar thotë:

الْيَتْلَمَىٰ فَأَنْكِحُوا مَا طَابَ لَكُمْ مِنَ النِّسَاءِ مَثْنَىٰ وَثُلَاثَ وَرُبْعَ مَثْنَىٰ خِئْتُمْ إِلَّا
تَعْدِلُوا فَوَاحِدَةً

“...atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, tri e me katra. E nëse i frikoheni padrejtësisë (ndaj tyre), atëherë vetëm më një...”³³.

Në kohën e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem e kishte pranuar islamin Gujlan eth-Thekafiu, i cili kishte dhjetë gra, e urdhëroi i Dërguari i All-llahut që t'i zgjedh katër prej tyre dhe të tjerat t'i shkurorëzojë.

Kajs Ibnul-Harith thotë: “Hyra në islam dhe kisha tetë gra, erdha ke i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem dhe i tregova, me tha: **“Zgjedhi prej tyre katër”³⁴.**

³³ (En-Nisa 3)

³⁴ Tra. Ebu Davudi (2241).

Dobitë e poligamisë:

1. Në disa raste është e domosdoshme, si p.sh; nëse gruaja është e moshuar ose është e sëmuar, dhe nëse nuk martohet më ndonjë grua tjetër, kjo nuk i mjafton për ta ruajtur vetvetën dhe për të pasur fëmijë, po ashtu nëse e mban frikohet se do të përballet më vështirësi të ndryshme ose ndoshta do të frikësohet nga zinaja, e nëse e shkurorizon e ndan nga fëmijet e saj, nuk ka mundësi te tejkalohet ky problem pos përmes poligamisë.

2. Nikahu është shkak për lidhje dhe afrim mes njerzve, dhe e ka bërë All-llahu të ngjashëm me farefisin, thotë All-llahu i lartësuar:

وَهُوَ الَّذِي خَلَقَ مِنَ الْمَاءِ بَشَرًا فَجَعَلَهُ نَسَبًا وَصِهْرًا

"Dhe Ai nga uji (fara) krijoi njeriun, e bëri atë të ketë fis dhe të ketë miqësi..."³⁵.

Poligamia është shkak për lidhjen e shumë familjeve, e afron njerin me tjetrin, dhe ky ka qënë njeri prej shkaqeve që e ka shtyer Pejgamberin sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem të martohet me më shumë gra.

3. Përkujdesja ndaj shumë grave, të kryerit e nevojave të tyre, siç është furnizimi, strehimi, pastaj të shtuarit e fëmijëve dhe shtimi i pasardhësve, ngase kjo është gjë e kërkuar nga sheriat.

4. Ka mashkuj që për shuarjen e epshit nuk i mjafton një grua, është i devotshëm dhe i ndershëm, frikësohet nga zinaja, mirëpo dëshiron të kënaqet në mënyrë të lejuar, për këtë ka qënë prej mëshirës se All-llahut az-ze ve xhel-l ta bejë të lejuar poligamin në formë të rregulltë.

³⁵ (El-Furkan: 54)

Kapitulli i shtatë

Urtësia e nikahit

Para se te fillojmë të flasim rreth thelbit të kësaj çështjeje, duhet ta dimë bindshëm se dispozitat e sheriatit janë të stërmbrushura më urtësi dhe të gjitha janë të vëndosura në vendin e duhur, dhe nuk ka diqka kot apo prej mendjelehtësisë, për arsye se janë prej të Urtit, dhe të Dijëshmit.

Mirpo këto urtësi a janë të njohura të gjitha për krijesat?

Me të vërtetë njerzimi janë të kufizuar në dituri, meditim dhe mendje, nuk ka mundësi të njoh çdo gjë, dhe nuk mund të arrijë çdo gjë, thotë All-Ilahu i lartësuar:

وَمَا أُوتِيتُمْ مِّنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا

***"...e juve ju është dhënë fort pak dije"*³⁶.**

Pra, dispozitat e sheriatit të cilat All-Ilahu i lartësuar i ka bërë obligim ndaj robëve të Vet është detyrë e jona të pajtohemi më to, varësisht se a e kemi të njohur urtësinë e tyre apo jo, sepse nëse nuk e kemi të njohur urtësinë e tyre nuk d.m.th. kjo se nuk ka fare urtësi në to në vërtetë, por kjo do të thotë se mendjet dhe përceptimet tona janë të mēngēta për ta kuptuar urtësinë e tyre.

³⁶ (El-Isra: 85)

Prej urtesive të nikahut janë:

1. Ruajtja dhe mbrojtja e të dy bashkëshortëve; Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem thotë: **"O jut të rinjë?! Kush ka mundësi për t'u martuar, le të martohet, sepse kjo e ruan shikimin dhe e mbron moralin"**³⁷.
 2. Ruajtja e shoqërisë nga të këqijat dhe shthurja morale, sikur të mos ishte nikahu, do të përhapeshin vese të këqija dhe të ulta mes mashkujve dhe femrave.
 3. Kënaqësia e të dy bashkëshortëve, njëri me tjetrin duke i përmbushur obligimet ndaj njëri-tjetrit si dhe të ketë mirësjellje reciproke në mes tyre, burri kujdeset për gruan, e furnizon me ushqim dhe pije, i siguron vendbanim dhe veshmbathje ashtu si ka mundësi, pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **"E keni obligim t'i furnizoni dhe t'i veshmbathni aq sa keni mundësi"**³⁸.
- Gjithashtu gruaja kujdeset për burrin duke i përmbushur obligimet që i takojnë në shtëpi, duke u përkujdesur dhe interesuar për shtëpi, Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem thotë: **"Gruaja është kujdestare në shtëpinë e burrit të saj dhe është përgjegjëse ndaj asaj që i është dhënë në përgjrgjësi"**³⁹.
4. Vendosja e lidhjeve mes familjeve dhe fiseve, sa prej familjeve të largëta nuk e kanë njohur njëri-tjetrin, kurse për mes martesës janë njohur dhe kanë pasur lidhje mes veti, për këtë e ka bërë All-llahu i Lartësuar dhendërin si pjestarë të farefisit siç e kemi cekur më lartë.

³⁷ Tra. Buhariu (5066), Muslimi (1400).

³⁸ Tra. Ahmedi (5/73), Ebu Davudi (1905), Iben Maxheh (3074).

³⁹ Tra. Buhariu (5188), Muslimi (1829).

5. Ruajtja e gjinisë njerzore në formë të shëndoshë, nikahu është shkak për shtuarjen e pasardhësve për mes të cilve vazhdon mbijetimi i racës njerëzore, thotë All-llahu i Lartësuar:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا
وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً⁴⁰

“O ju njerëz! Kinie frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra...”⁴⁰.

Sikur mos të ishte nikahu atëherë do të shfaqej njëra prej dy gjerave”

- shuarja e njerzimit;
- ose ekzistimi i njeriut të zhvilluar nga kurvëria që nuk i dihet (baza) familja, dhe nuk është i ngritur në moral.

Këtu më duhet të ndalem një qast, ta sqarojmë se çka është vendimi i Islamit lidhur me përkufizimin familjar.

Them, se përkufizimi i fëmijëve në numër të caktuar është në kundërshtim me kërkesën e sheriatit, sepse Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka urdhëruar për t'u martuar më gruan që lindë shumë fëmijë dhe na e ka sqaruar se më këtë mburret para umeteve tjera apo pejgamberve alejhimus-sel-lam.

Kanë thënë dijetarët është obligim për t'u martuar me gruan që njihet se lindë shumë, e kjo dihet ose duke e njohur përshtetësisht atë grua nëse ka qenë e martuar me parë, ose duke i njohur të afërmet e saj, si nënën e saj apo motren e saj, nëse nuk ka qenë e martuar me parë.

⁴⁰ (En-Nisa 1)

Cili është shkaku që i detyron në përkufizimin e fëmijve?

A mos është frika nga rizku, apo frika nga lodhja duke i edukuar (mos edukimi i mirë)?

Nëse është e para, atëherë ky është paragjykim i keq ndaj All-llahut të Lartësuar, sepse All-llahu nëse krijon krijesa patjetër Ai i furnizon ato, thotë All-llahu i Lartësuar:

وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ إِلَّا عَلَى اللَّهِ رِزْقُهَا

"Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që All-llahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj"⁴¹.

Gjithashtu në një ajet tjetër thotë:

وَكَايْنِ مَنْ دَابَّةٍ لَا تَحْمِلُ رِزْقَهَا اللَّهُ يَرْزُقُهَا وَإِيَّاكُمْ ۖ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

"Sa e sa gjallesa janë që nuk kanë mundësi për furnizimin e vet, All-llahu i furnizon ato edhe juve. Ai është dëgjuesi, i dijsmi"⁴².

All-llahu i plotëfuqishëm iu thotë atyre te cilët i mbytnin fëmijët e tyre nga frika e varfërisë:

إِنَّمَا لَقِيْتُمْ نَحْنُ نَرْزُقُهُمْ وَإِيَّاكُمْ ۖ

"...se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve..."⁴³.

Nëse shkaku për përkufizimin e fëmijve është frika nga lodhja duke i edukuar, kjo është gabim, ngase ka shumë që kanë fëmijë pak dhe janë lodhur duke i edukuar, gjithashtu ka prej tyre që kanë fëmijë shumë dhe edukimi i tyre ka qenë i lehtë për ta.

⁴¹ (El-Hudë 6)

⁴² (El-Ankebut 60)

⁴³ (El-Is'ra 31)

Çështja e edukimit se a është i rëndë apo i lehtë është e lidhur ngushtë me lehtësim nga All-llahu i Lartësuar, sa më shumë që robi ia ka frikën All-llahut, dhe vazhdon rrugës së drejtë, All-llahu ia lehtëson problemet, All-llahu i Lartësuar thotë:

وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ لَهُ مِنْ أَمْرِهِ يُسْرًا

***"E kush i frikësohet All-llahut, Ai atij ia lehtëson punën"*⁴⁴.**

Pasi të bëhet e qartë se përkufizimi i fëmijve është në kundërshtim me shariatën, shtrohet pyetja: Planifikimi familjarë si shkak i gjendjes së nënës a është i këtij lloji?

Përgjigjeja është jo, nuk është planifikimi familjar për shkak të gjendjes së nënës i ngjashëm me përkufizimin e fëmijve. Me shprehjen planifikimi familjar kamë për qëllim, që të dy bashkëshortët apo ndonjëri prej tyre të përdorë masa që e pengojnë shtatëzaninë përkohsisht, dhe kjo është e lejuar nëse bëhet me pëlqimin e të dy palëve, si p.sh.: te jetë femra e dobët, kurse shtatëzania e shton dobësinë apo sëmundjen, atëherë me pëlqimin e bashkëshortit përdorë hapa (ilaje) që e pengojnë shtatëzaninë përkohsisht, dhe në këtë nuk ka fare të keqe.

Sepse sahabet kanë bërë azel⁴⁵ në kohën e Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem dhe nuk janë ndaluar nga kjo, kurse dihet se azeli është një prej shkaqeve që e pengon shtatëzaninë.

⁴⁴ (Et-Talak 4)

⁴⁵ Azel- është te menjanuarit e spermës jashtë vaginës apo siç është e njohur tanimë perdorimi i mjeteve prezervative.

Kapitulli i tetë

Gjërat që pasojnë nikahun

Gjërat që e pasojnë nikahun janë të shumta, do t'i përmëndim siç vijon:

1. Dhënja e mehrit; "Meher" d.m.th. dhuratë apo siç quhet në gjuhën popullore (xhehaz apo xheiz) përgatitje, mehri bëhet obligim ndaj gruas me rastin e martesës, varësisht a e kushtëzon apo nuk e kushtëzon, e ai (mehri) është: "***Pasuria që i ipet gruas për shkak të kurorizimit***".

Nëse mehri është i përcaktuar, ai mbetet aq sa përcaktohet qoftë pak apo shumë, e nëse nuk përcaktohet por vetëm bëhet akti i nikahut dhe nuk i ipet mehri, e as që përmëndet fare, atëherë ndaj bashkëshortit është obligim t'ia jap gruas mehrin e ngjashëm me gratë tjera, pra shuma e këtij mehri është aq sa është traditë në atë vend.

Pasi që mehri mund të jetë pasuri, gjithashtu mundet me qenë edhe ndonjë gjë e dobishme, ngase Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem e martoi një grua me një burrë më kusht që t'ia mësojë një pjesë nga Kur'ani⁴⁶.

Është e preferuar që mehri të jetë i ulët, ngase sa më i ulët dhe i lehtë të jetë është më mirë, duke pasur për shëmbulltyrë Pejgamberin sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem dhe duke shpresuar të jetë më i begatshëm.

⁴⁶ Tra. Buhariu (5087), Muslimi (1425).

Më të vërtetë nikahu më i begatshëm është ai më i lehtë në përgatitje, transmeton Muslimi në koleksionin e tij të vërtetë: **Një njeri i kishte thënë Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem; "Kam martuar një grua. I tha: Sa i ke dhanë mehër? I tha: Katër evak⁴⁷ (160 dirhem).** Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem i tha: **Për katër evak!, ju mendoni sikurse ju po nxjerrni argjend prej kesaj kodre, nuk kam çfarë të jap, mirëpo ndoshta të dërgojmë në ndonjë aksion dhe do të fitosh prej tij diç⁴⁸.**

Umeri Allahu qoftë i kënaqur me të ka thënë: "Mos e teproni në mehrat (dhuratat) e grave, me të vërtetë po të ishte e dobishme në këtë botë apo në ahiret, Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem i pari do e bënte këtë, nuk i ka dhënë ndonjë gruajë prej grave të veta, e as ndonjëres nga vajzat e veta më shumë se dymbëdhjetë evkijeh, kurse një evkijeh është katerdhjetë dirhem".

Me të vërtetë është bërë ngritja e mehrit në kohët e fundit dhe ka lenë gjurmë të këqija duke u'a pamundësuar martesën e shumë burrave dhe grave, dhe si rrjedhojë e kesaj burrit i është dashur shumë kohë të kalojë për të arritur shumën e duhur të mehrit, kështu që ka pasuar shumë dëme, prej tyre i veqojmë:

- ua ka pamundësuar martesën shumë burrave dhe grave;
- familja e femrës shiqon në vlerën (se sa është është) mehri, pak apo shumë, dhe në shumicën e rasteve mehr është ajo që e përfitojnë familja e gruas nga burri për vajzën e tyre, në qoftë se është mehri shumë e martojnë vajzën e tyre duke mos shikuar në pasojat e asaj martese, e nëse është mehri i vogël e refuzojnë edhe në qoftë se janë të kënaqur në fenë dhe moralin e tij (burrit).

⁴⁷ Një "evak" është 40 dirhem, që gjithsejt është 160 dirhem.

⁴⁸ Tra. Muslimi (1424).

- nëse ka mospajtime bashkëshortore, dhe mehri është i lartë, në shumicën e rasteve divorci nuk bëhet me mirëkuptim, përkundrazi e torturon (burri gruan e tij) më qellim për t'i kthyer gruaja diç nga mehri që i ka dhënë, e sikur të ishte më i vogël edhe ndarja pa dyshim do të ishte me lehtë.

Sikur njerëzit të ishin më modestë në mehr, dhe sikur të bashkëpunonin mes veti, dhe të kishin filluar njerëzit ta praktikonin një gjë të tillë, do të kishte dobi e gjithë shoqëria, dhe do të gjente një rehati të madhe dhe do t'i ruante shumë mashkujt dhe femrat nga haramet.

Mirëpo më keqardhje i vërejmë disa njerëz duke garuar në ngritjen e mehrit dhe shtimin e tij, çdo vit shohim gjëra të shtuara (në mehr) që nuk ishin të njohura më parë, dhe nuk e dimë se ku do të ndalen.

Me të vërtetë kishte njerëz, e sidomos prej atyre nga zonat rurale që bënin disa lehtësime në lidhje me mehrin, e ky lehtësim ishte mosmarrja e menjëhershme e një pjesë të mëhrit, si p.sh.: ta martojë femrën me një meher të caktuar, dhe një pjesë e jep menjëherë e një pjesë e jep më vonë, duke e vonuar deri një vit, më pak apo më shumë, e kjo i bënë shumë lehtësime burrit.

2. Furnizimi; ndaj bashkëshortit është obligim furnizimi i bashkëshortës me të mirë, siq është: ushqimi, pija, veshmbathja dhe vendbanimi, në qoftë se është koprrac në ndonjë nga këto obligimet atëherë është mëkatarë, dhe femra në këtë rast ka të drejtë të marrë nga pasuria e tij aq sa i nevojitet, apo huazon diku ndërsa burri e ka për obligim kthimin e borxhit.

Prej llojit të furnizimit konsiderohet edhe velimja, e ajo është të përgatiturit e ushqimit gjatë ceremonis së martesës, duke i ftuar të tjerët në ushqim, gjë e cila është prej sunnetit që jemi të obliguar me të, sepse Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem kështu ka vepruar dhe ka urdhëruar të veprohet.

Duhet të kemi parasysh se e kemi obligim të largohemi nga shpenzimi i tepërt në velime, po ai të jetë aq sa ka mundësi bashkëshorti.

Kurse ajo që e bëjnë disa njerëz duke shpenzuar gjëra të shumta dhe të ndryshme, më të vërtetë nuk duhet, ngase ky është shpenzim i pasurisë pa dobi.

3. Marrdhëniet mes bashkëshortëve dhe familjeve të tyre; All-llahu ka bërë që në mes bashkshortëve të ketë dashuri dhe mëshirë, dhe kjo lidhje tërhek pas vete obligime të njohura nga tradita, dhe aq sa forcohet kjo lidhje shtohen obligimet.

4. Ndalesa që ka të bëjë me martesë (mahremi); burri e ka të ndaluar martesën me nënat e grave të tij dhe gjyshet e tyre, gjithashtu e ka të ndaluar të martohet më vajzat e tyre dhe bijat e vajzave të tyre, nëse ka pas marrëdhënie intime me nënat e tyre , po ashtu gruaja e ka të ndaluarë të martohet me prindin apo gjyshin e burrit dhe me djemët e tij.

- 6. Trashegimia;** posa ta bëjë aktin e kurorizimit burri me gruan, aty për aty fillon çështja e trashegimisë mes njeri-tjetrit, All-llahu i lartësuar thotë:

وَلَكُمْ نِصْفُ مَا تَرَكَ أَزْوَاجُكُمْ
مِمَّا تَرَكَنَّ مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصِيَنَّ بِهَا أَوْ

***“Juve ju takon gjysma e asaj (pasurie) që e lënë
gratë tuaja.....pas kryerjes se testamentit që
keni përcaktuar ose borxhit”⁴⁹,***

dhe nuk ka dallim a ka pasur marrdhenie intime apo nuk ka pasur, a është vetmuar me të apo nuk është vetmuar.

⁴⁹ (En-Nisa 12)

Kapitulli i nëntë

Dispozitat e divorcit

Shkurorizim apo divorc do të thotë: ndarja e burrit nga gruaja qoftë me fjalë, me shkrim apo duke i dhënë shenjë.

Parimisht shkurorizimi është mekruh sepse për mes tij behët shuarja e të dobive që rrjedhin si shkak i nikahut të cekura më lartë, si dhe bëhet shthurja e familjes, për këtë thotë Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem: **“Hallalli më i urrejtur tek All-llahu është divorci”**⁵⁰.

Mirëpo, pasiqë divorci në disa raste është i domosdoshëm, për shkak se gruaja ka zullum nga burri i vet, apo anasjelltas burri ka zullum nga gruaja e vet, apo për ndonjë shkak tjetër, All-llahu i lartësuar nga mëshira e Tij e ka bërë të lejuar divorcin për robët e vet, dhe nuk e ka penguar kështu që t’i vëjë në siklet dhe mundim krijesat e veta.

Nëse bashkëshorti e urren bashkeshortën e vet, dhe nuk mund të bënë durim ndaj saj, atëherë nuk ka të keqe nëse e shkurorizon, mirëpo është obligim t’i ketë parasysh disa çështje, siq janë:

1. Mos ta shkurorizoi duke qenë në kohën e menstruacioneve; nëse e shkurorizon duke qenë në haid (menstruacione) vetëm se ka bërë mëkat ndaj All-llahut dhe të Dërguarit të Tij sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, dhe është zhytur në një haram, kështu që e ka obligim ta kthejë dhe të pres derisa të pastrohet, pastaj mundet ta shkurorizojë nëse dëshiron, po më mirë është të pret derisa t’i shfaqet haidi për herë të dytë, e kur të pastrohet nëse dëshiron e mbanë e nëse dëshiron e shkurorizon.

⁵⁰ Shejh Albani thotë se hadithi është daif; el-Iruaul-Galil (8/2040), Daif el-Xhamius-Sagir (f.8).

2. Mos ta shkurorizoi nëse ka bërë mardhënie me graun pas menstruacioneve (d.m.th kur është e pastër), vetëm në qoftë se e dinë se ajo është shtatzënë.

Nëse njeriu vendos për ta shkurorizuar gruan e tij, kurse ai ka pasur mardhënie intime me të pas menstruacioneve, në këtë rast nuk lejohet ta shkurorizojë përderisa t'i shfaqet haidi dhe të pastërohet përsëri, edhe nëse kjo periudhë zgjat, pastaj nëse dëshiron e shkurorizon para se të ketë kontakt me të. Në qoftë se i bëhet e qartë se ka mbetur shtatzënë apo vërtetohet se është shtatzënë, nuk ka të keqe nëse e shkurorizon, All-llahu i Lartësuar thotë:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِذَا طَلَّقْتُمُ النِّسَاءَ فَطَلِّقُوهُنَّ لِعَدَّتِهِنَّ

"O ti pejgamber, kur t'i lëshoni gratë, lëshoni ato në vigjilje të fillimit të pitjes së tyre (në kohën e pastërtisë së tyre)..."⁵¹.

Ka thënë Iben Ab-basi radijall-llahu anhumu: "Mos te shkurorizoi duke qenë në kohën e haidit, e as duke qenë në kohën e pastërtisë nga haidi përderisa ka pas mardhënie me të, mirëpo le të pret deri sa të shfaqet haidi dhe të pastrohet prej tij, pastaj e shkurorizon".

3. Mos ta shkurorizoi më shumë se një herë; le të mos i thotë: ti je e lëshuar dy herë apo tri herë, apo mos t'i thotë: ti je e lëshuar, ti je e lëshuar, ti je e lëshuar, divorci në këtë formë është i ndaluar bazuar në atë që transmetohet nga Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem t'i ketë thënë një njeriu ta kishte shkurorëzuar gruan e vet duke i thënë tri herë ti je e lëshuar: "A po tallet me Librin e All-llahut e unë jam në mesin tuaj? Derisa është ngritur një njeri dhe ka thenë: A ta vras?"⁵²

⁵¹ (Et-Tal-lak 1)

⁵² Tra. Nesaiu (2401).

Shumë prej njerzve nuk i dijnë dispozitat e shkurorëzimit, në çfarë do kohe ju teket, i shkurorëzojnë gratë e tyre duke mos marrë parasysh kohën apo numrin e shkurorëzimit.

Është obligim për njeriun që t'iu përmbahet dispozitave të All-llahut të Plotëfuqishëm, dhe mos t'i tejkalojë sepse ka thënë All-llahu i Lartësuar:

اللّٰهُ ۚ وَمَنْ يَتَعَدَّ حُدُودَ اللّٰهِ فَقَدْ ظَلَمَ نَفْسَهُ ۚ

***"...e kush del jashtë dispozitave të All-llahut, ai e ka demtuar vetveten."*⁵³.**

Në një ajet tjetër thotë:

وَمَنْ يَتَعَدَّ حُدُودَ اللّٰهِ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ

***"...kush i tejkalon dispozitat e All-llahut, pikërishtë të tillët janë zullumqarët"*⁵⁴.**

⁵³ (Et-Tal-lak 1)

⁵⁴ (El-Bekare 229)

Kapitulli i dhjetë

Gjërat që e pasojnë divorcin

Pasi që divorci konsiderohet ndarja e gruas nga burri, atëherë këtë e pasojnë dispozita të shumta prej tyre veçojmë:

1. Për gruan është obligim ideti (kohëpritja pas divorcit) në qoftë se burri ka kryer marrëdhënie intime me të apo është vetmuar me të.

Nëse e shkurorëzon para kontaktit seksual dhe vetmimit, gruaja nuk e ka obligim idetin, thotë All-llahu i lartësuar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا نَكَحْتُمُ الْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ طَلَقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَمْسُوهُنَّ
فَمَا لَكُمْ عَلَيْهِنَّ مِنْ عِدَّةٍ تَعْتَدُونَهَا⁵⁵

“O ju që besuat, kur të keni lidhur kurorë me besimtare të pastaj i lëshoni ato para se të keni kontaktuar me to, ju nuk keni të drejtë të kërkonit që ato të presin afatin e caktuar (iddetin)...”⁵⁵.

Ideti-afati i pritjes është tri periudha të haidit nëse femra është prej atyre që i është shfaqur haidi, dhe tre muaj nëse nuk është prej atyre që i shfaqet haidi, ndërsa nëse është shtatëzënë derisa të lindë ²⁰.

2. Gruaja bëhet haram për burrin në qoftë se para kësaj here e ka shkurorëzuar dy herë, d.m.th. nëse e shkurorëzon pastaj e kthen gjatë kohës se idetit, apo e marton pas idetit, pastaj prapë e shkurorëzon për të dytën herë dhe e kthen gjatë kohës se idetit apo e marton pas idetit, pastaj prapë e shkurorëzon për të tretën herë, në

⁵⁵ (El-Ahzab 49)

²⁰ Sh. p. ndërsa, nëse i vdesë burri kohëpritja e gruas është katër muaj e dhjetë ditë në qoftë se nuk është shtatëzënë, ndërsa nëse i vdes burri e ajo është shtatëzënë atëherë derisa të lindë.

këtë rast nuk i lejohet të martohet me të përveç nëse ajo (gruaja) martohet më një burrë tjetër, dhe bën martesë të vërtetë, bënë mardhënie intime me të, pastaj atijë (burri) nuk i pëlqen ajo dhe ndahet prej saj, pas kësaj here i lejohet burrit të parë të martohet më të, bazuar në fjalën e All-llahut të lartësuar:

الطَّلَاقُ مَرَّتَانٍ ۖ فَإِمْسَاكَ بِمَعْرُوفٍ أَوْ تَسْرِيحٌ بِإِحْسَنٍ ۚ

"Lëshimi (pas së cilit mund të bëhet rikthimi) është dy herë, e (pastaj) ose jetë e njërzhishme (bashkëshortore) ose shkurorëzim me mirëkuptim"⁵⁶,

deri sa ka thënë në ajetin tjetër:

فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا تَحِلُّ لَهُ مِنْ بَعْدُ حَتَّى تَنْكِحَ زَوْجًا غَيْرَهُ ۚ فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا أَنْ يَتَرَاجَعَا إِنْ ظَنَّا أَنْ يُقِيمَا حُدُودَ اللَّهِ ۚ وَتِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ يُبَيِّنُهَا لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ

"E në qoftë se ai (burri) e lëshon atë...", për herën e tretë; ***"...pas atij (lëshimi) nuk i lejohet më derisa të martohet ajo për një burrë tjetër. E nëse ai e lëshon atë..."***d.m.th. burri i dytë, ***"...atëherë për ata të dy, po që se mendojnë se do t'i zbatojnë dispozitat e All-llahut, nuk ka pengesë..."*** d.m.th. burri i parë dhe gruaja e tij të cilën e ka shkurorëzuar, ***"...të rikthehen (në bashkëshortësi). Këto janë dispozita të All-llahut që ia sqaron një populli që kupton"***⁵⁷.

All-llahu i lartësuar e ka bërë të ndaluar martesën e gruas me burrin i cili e ka shkurorëzuar tri herë përveç nëse martohet me një burrë tjetër pas tij, sepse njerzit në fillim të islamit i kanë shkurorëzuar gratë dhe rikthyer ato duke mos marrë parasysh numrin e shkurorëzimit.

⁵⁶ (El-Bekare 229)

⁵⁷ (El-Bekare 230)

Sa që një njeri është hidhëruar në gruan e vet dhe i ka thënë: "Për All-llahun nuk të afrohem, e as nuk të ndaj! Është drejtuar gruaja duke i thënë: E si bënë kjo?! Tha: Të shkurorëzoj, pastaj sapo të afrohet koha e skadimit të afatit të pritjes të rikthej, pastaj prapë të shkurorëzoj, pastaj sapo të afrohet koha të rikthej, Bashkëshortja e tij shkoi te i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem dhe i tregoi për këtë, pastaj All-llahu zbriti ajetin Kur'an-orë:

الطَّلُقُ مَرَّتَانِ

"Lëshimi (pas së cilit mund të bëhet rikthimi) është dy herë..."⁵⁸.

Për këtë arsye është konsideruar përkufizimi i shkurorëzimit me tri herë mëshirë për gratë prej padrejtësisë se burrave të tyre.

⁵⁸ (El-Bekare 229)

Vellëzër të ndëruar!

Shpresoj se kemi sjellur fjalë të shumta rreth dispozitave të nikahut, duke pasur kujdes të jetë në mënyrë të përshtatshme, jo e gjatë e tepruar dhe jo e shkurtë e e mangët.

E lus All-llahun e Lartësuar që të ketë dobi prej saj, t'i bëjë veprat tona të singerta për Të (All-llahun), në pajtim me kenaqësinë e Tij subhanehu ue te'ala. Dhe të bëjë prej këtij ummeti gjënerata të dijshe me ligjet e Zotit dhe përmbajtës ndaj dispozitave të Tij, respektuese ndaj urdhërave të Tij, si dhe udhëzues për robët e Tij.

Zoti ynë, mos na i devijoj zëmrat tona pasi na i drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, ngase vetëm Ti je dhuruesi i madh.

Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë, dhe në botën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit me zjarr!

Ue sal-lall-llahu ala nebij-jinaa Muhammedin ue ala alihi ue sahbihi ve sel-lem.

